Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-218
Datë 16.06.2016

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 26.05.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Kolegjit UBT në Prishtinë, për periudhën 3 vjeçare, prej 26. 05. 2016 deri 26. 05. 2019 për këto kualifikime të aprovuara:

1.1. Asistent Administrativ, niveli i KKK-së (III).

1.2. Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- Institucioni(UBT) duhet të hartoj rregullore -manualin dhe procedurat që nga aplikimi, ndjekja e trajnimit, vlerësimi deri tek marrja e certifikatës për profilin Asistent Administrativ.
- Institucioni (UBT) duhet të sistemoj të gjitha pajisjet (PC, aparat fotokopje, Skaner, Telefaks, Telefon fiks me ekstensione, orman për arkivimin e dosjeve) të nevojshme, të parapara si pas standardit asistent administrativ, në një sallë (zyre) të vetme e cila do të shërbej për ushtrime dhe simulime praktike.
- Institucioni (UBT) duhet të emëroj me vendim një koordinator të zyrës për cilësi i cili do të merret me procedura dhe përcjelljen e procesit për profilin në fjalë.
- Institucioni (UBT) duhet të hartoj rregullore për zhvillimin e pjesës praktike të kandidatëve jashtë institucionit.

- Institucioni (UBT) duhet të zhvillojë testin hyrës duke përfshirë edhe njohuritë paraprake për profilin Asistent Administrativ.
- Institucioni (UBT) duhet t'i harmonizoj dhe azhurnoj modulet duke ju referuar standardit të profesionit Asistent Administrativ.
- Institucioni (UBT) duhet të zhvillojë testin përfundimtar konform sistemit modular.

(Afati kohor: 15. 07. 2016).

1.3. Teknologji e Informacionit dhe e Komunikimit, niveli i KKK-së (II).

1.4. Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- Të ofrohet dëshmi për zhvillimin profesional të stafit.
- Të ofrohen ekzemplarë të paketave mësimore (literaturës mësimore).
- Të ofrohen ekzemplarë të testeve të rregullta dhe projekteve finale.
- Të riorganizohet numri i kredive.
- Riorganizimi i sallave mësimore të objektit në Prishtinë në mënyrë që hapësirat në mes të tavolinave të jenë të mjaftueshëm për kalim të studentëve.
- Të definohet koha e arkivimit të provimeve, testeve dhe ushtrimeve.
- Të riorganizohet stafi në zyrën për sigurimin e cilësisë.
- Të mundësohet qasja në katet e objektit për personat me karroca në objektin në Prishtinë.
- Riorganizimi i sinjalizimit në hapësirën e brendshme.
- Mbrojtja e të dhënave personale.
- Numri i orëve për modul në aplikacionin e validimit dhe në dokumentet e tjera ka dallime. Të harmonizohen këto dallime dhe të dihet numri i saktë i orëve dhe kredive.
- Të caktohet së paku një koordinator i cilësisë i cili do të ketë kohë dhe hapësirë për të zhvilluar dhe koordinuar kontrollin e cilësisë.
- Shkallët emergjente tek objekti në Prishtinë nuk plotësojnë kushtet për të qenë të tilla pasi që janë në hapësirat e brendshme dhe përdoren pothuajse gjatë gjithë kohës dhe janë të njëjta me shkallët e rregullta.

(Afati kohor: 15. 07. 2016).

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 26.05.2016, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacionet për Validim të Kualifikimit/Modulit;

- Aplikacionet për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit UBT; dhe
- AKK.



Kryetari i KD së AKK-së
Osman Buleshkaj